

VENDIM
Nr. 239, datë 27.3.2013

PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË RE TË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet kundërparti, të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si agjenci e pagesave, në shumën 173 095 454 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit, brenda vitit 2013.

2. Këto fonde të përdoren nga AZHBR-ja në formën e kreditimit pa interes, me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe përpunimin e këtyre produkteve. AZHBR-ja mund të fillojë disa herë në vit procedurën e pranimit dhe vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve të mbledhura.

3. Vlerat monetare që do të përdoren për mbështetjen e zhvillimit bujqësor, të jenë në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit.

4. Me këto fonde të financohen investimet për:

a) blerje dhe instalim të dhomave frigoriferike;
b) linjat e seleksionimit dhe përpunimit të prodhimit të arrorëve, gështenjës dhe shegës;
c) ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse;

ç) blerjen e traktorëve e të mekanikës bujqësore;

d) ngritjen e fidanishteve, serrave për prodhimin e fidanëve të arrës;

dh) përpunimin, ruajtjen dhe ambalazhimin e vajit të ullirit;

e) përpunimin, ruajtjen dhe ambalazhimin e verës;

ë) përpunimin, ruajtjen e bimëve mjekësore.

5) Masa e financimit për këto veprimtari, nga këto fonde, të jetë në varësi të llojit dhe të vlerës së investimit:

a) Deri në 60% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për ngritjen e dhomave frigoriferike;

b) Deri në 80% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë, për blerjen e linjave të reja ose rinovimin e linjave ekzistuese të seleksionimit, ruajtjes dhe përpunimit të arrorëve, gështenjës dhe shegës;

c) Deri në 50% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale për prodhimin e qumështit e të mishit, si dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse;

ç) Deri në 8 (tetë) milionë lekë për investimet në blerjen e traktorëve e të mekanikës bujqësore;

d) Deri në 80% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, për ngritjen e serrave për prodhimin e fidanëve të arrës;

dh) Deri në 50% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për përpunimin, ruajtjen dhe ambalazhimin e vajit të ullirit;

e) Deri në 50% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për përpunimin, ruajtjen dhe ambalazhimin e verës;

ë) Deri në 60% të vlerës së përlllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 000 000

(pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për ruajtjen, përpunimin dhe ambalazhimin e bimëve mjekësore.

6. Këto vlera monetare të livrohen për të mbështetur zhvillimin e veprimtarive të mësipërme në formën e kredive pa interes, me maturim 7-vjeçar.

7. Procedura, kriteret e përgjithshme të përfitimit të kredisë dhe mënyra e administrimit të fondit të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Financave. Ministria përgjegjëse për bujqësinë përcakton kushtet specifike në lidhje me shpërndarjen gjeografike dhe përparësitë e projekteve investuese, në përputhje me planet kombëtare të zhvillimit agro-ushqimor.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministra e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha